



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVO-SKUPSTINA OPŠTINE MALISHEVO



PROCESVERBAL

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 11-12-2024
PRIMJENO:
Mr. No. R. 02/450

i mbledhjes së -II- (dytë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 27.09.2024 dhe filloi në ora: 17:00.

Në mbledhje morë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Gentianë Hoti, Arlindë Rudi, përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

Mungon: Hamit Lima, Sadik Vrenezi dhe Veton Zogaj.

Argjend Thaçi: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!

Hapi mbledhjen e -II- (dytë) urgjente të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 4 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Mbledhja është thirrur në ora 13:30 mirëpo për shkak të mungesës së kuorumit është shtyrë për ora 17:00.

Kush është për miratimin e rendit të ditës?

Me vota unanime të 4 anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës

1.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës. nr.04/775 datë: 30.08.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për projekt buxhetin për vitin 2025/2027, me theks të veçantë për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Urdhëro, drejtor!

Drejtori për Buxhet dhe Financa Blerim Thaçi: Komuna e Malishevës në vitin 2025 ka një buxhet me vlerë 21,499,545.01E, të shpërndara në 5 kategori ekonomike.. Në kategorinë paga dhe meditje janë të planifikuara 11,713,202.00E, mallra dhe shërbime 2,600.00.00E, komunalit janë 600,000.00E, subvencione dhe transfere janë 600,000.00E dhe investime kapitale janë 6,063,143.00E.

Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi: Kush është për rekomandim për kuvend të kërkesës nr.04/775 datë: 30.08.2024, e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për projekt buxhetin për vitin

2025/2027, me theks të veçantë për vitin 2025?

Me vota unanime të 4 anëtarëve, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora:17:15.

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi

